

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Kompania Rajonale e Ujësjetësit GJAKOVA SH.A.**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **KRURGJA-24-12250-1-2-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me kompjuter dhe laptop**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	Pattern SH.P.K.
NUI	811976903
Adresa	Rruga Ruzhdi Shabani, nr 47
Vendi	Lipjan
Kodi postar	14000
Numri Telefonit	049570110
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Egzon Rizani
Adresa elektronike	patternshpk@yahoo.com
Data e parashtrimit të ankesës	29.12.2024

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Furnizim me kompjuter dhe laptop

Përmbledhje e Aktivitetit të Prokurimit

Njoftimi për Kontratë: Publikuar më 20.11.2024, ora 15:39.

Dosja e Tenderit: Përgatitur më 20.11.2024, ora 14:19.

Përshkrimi i Çmimeve: Përfunduar më 20.11.2024, ora 14:26.

Procesverbali i Hapjes: Përgatitur më 12.12.2024, ora 13:24.

Njoftimi mbi Vendimin e AK-së: Lëshuar më 17.12.2024, ora 10:29.

Kërkesa për Rishqyrtim: Paraqitur më 20.12.2024.

Vendimi për Kërkesën për Rishqyrtim: Lëshuar më 23.12.2024

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Autoriteti Kontraktues nuk e ka marrë parasysh kërkesën tonë për rishqyrtim përkundër argumenteve të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 59

Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

2. Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohej ose pranohet nga autoriteti kontraktues ose të ofrohet nga një tenderues.

3. Autoriteti kontraktues do të përmirësojë gabimet në një tenderë të cilat janë tërësisht aritmetike, nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve. Autoriteti kontraktues menjëherë do t'i dërgojë të gjithë tenderueseve përkatës një njoftim me shkrim mbi ndryshimet e tilla.

Neni 60

Kriteret për Dhënien e Kontratës

1. Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar ose:

1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët;

1.2 tenderin ekonomikisht më të favorshëm në bazë të kriterëve dhe peshën që është specifikuar në dosjen e tenderit sipas nenit paragrafit 3. të nenit 52 të këtij ligji.

Neni 72

Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjohë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Me këtë parashtrim të ankesës tonë lidhur me procesin e prokurimit të lartpërmendur, duke pretenduar se eliminimi ynë si operator ekonomik nga gara është në kundërshtim me

Ligjin për Prokurimin Publik (LPP), rregulloret përkatëse dhe udhëzuesit në fuqi.

Sipas Njoftimit për Eliminim, arsyet e dhëna për përjashtimin tonë janë:

1. Mospërmbushja e kërkesës III.2.4 për Kapacitetin Teknik dhe Profesional:

Pretendohet mungesa e broshurave ose katalogëve të nënshkruar nga prodhuesi për pajisjet e ofertës.

2. Mospërmbushja e kërkesës për vendin e origjinës në Pjesën II të Përshkrimit të Çmimeve.

Ne kundërshtojmë fuqishëm këtë vendim të Autoritetit Kontraktues Kompania Rajonale e Ujësjetës GJAKOVA SH.A., duke argumentuar se procedura e ndjekur nuk ka respektuar Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042 dhe aktet nënligjore përkatëse.

Argumentet Ligjore

1. Shkelja e **Nenit 72 të LPP-së Dokumentacioni dhe Informacioni Shtesë:**

Sipas Nenit 72 të LPP-së, AK ka obligimin të kërkojë sqarime ose informacione shtesë nëse dokumentet e paraqitura nga operatori ekonomik nuk janë të plota ose janë të paqarta. Në rastin tonë:

Ne kemi dorëzuar specifikacionet teknike për mallrat e ofruara, të cilat plotësojnë kërkesat e tenderit konkretisht dokumenti nr.8 i ngarkuar me titullin (8. Specifikat Teknike te ofruera)

Mungesa e katalogëve nuk është një arsye e mjaftueshme për eliminim, pasi AK kishte të drejtën dhe detyrimin të kërkojë sqarime shtesë, në përputhje me paragrafin 2 të Nenit 72 të LPP-së.

2. Shkelja e **Nenit 59 të LPP-së Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve:**

AK nuk ka respektuar procedurat e parashikuara për ekzaminimin e ofertave. Në vend që të kërkojë sqarime për mungesën e katalogëve, AK ka refuzuar ofertën tonë në mënyrë të padrejtë, duke shmangur detyrimet ligjore për një vlerësim të drejtë dhe të paanshëm.

3. Shkelja e **Nenit 60 të LPP-së Kriteret për Dhënien e Kontratës:**

AK ka anashkaluar të gjitha aspektet kryesore të ofertës sonë, të cilat plotësojnë kriteret thelbësore të tenderit, duke vendosur në mënyrë arbitrare eliminimin për mungesën e një elementi jo thelbësor si katalogët, të cilët mund të kërkoheshin si sqarim shtesë.

4. Shkelja e **RREGULLORES Nr. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK Neni 38:**

Sipas kësaj Rregulloreje, gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve, AK duhet të kërkojë informata shtesë kur mungon një dokument i tillë si katalogu apo broshura, për sa kohë që operatori ekonomik ka dorëzuar specifikacionet teknike për mallrat e ofruara.

5. Shkelja e UDHËZUESIT Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK:

Në pikën 10.1 të këtij udhëzuesi theksohet se, në rastet kur një operator ekonomik ka dorëzuar specifikacionet teknike për mallrat, por mungon katalogu, AK duhet të kërkojë sqarime shtesë dhe jo të eliminojë ofertën direkt.

Po ashtu, AK ka keqinterpretuar pjesën për vendin e origjinës në Përshkrimin e Çmimeve. Në këtë rast, vendi i origjinës është një element që mund të sqarohet dhe nuk është kusht për eliminim të menjëhershëm, për sa kohë çmimet janë të pranishme dhe të sakta.

Problematika shtesë në lidhje me Produktin Nr. 1

AK ka përfshirë specifikime të tejet detajuara për Produktin Nr. 1, duke përfshirë edhe elemente jofunksionale si ngjyra e produktit, e cila nuk ka asnjë ndikim në performancën ose funksionalitetin e tij. Përfshirja e këtyre detajeve të panevojshme shkel parimet e konkurrencës së lirë dhe tregon një përpjekje të qëllimshme për të favorizuar një operator të caktuar ose një grup operatorësh. Kjo praktikë është në kundërshtim të qartë me: Nenin 28 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP): Specifikimet teknike duhet të jenë të bazuara në karakteristikat funksionale dhe të performancës dhe nuk duhet të kufizojnë konkurrencën. Parimin e trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë (Neni 7 i LPP-së): Duke përfshirë specifikime jodomosdoshme dhe të panevojshme si ngjyra, AK ka krijuar një barrierë artificiale për konkurrencën.

Vendimi për Anulimin e Procedurës

Me vendimin për anulimin e të gjithë tenderit, AK ka demonstruar qartë që qasja fillestare – specifikimi i hollësishëm dhe i panevojshëm për Produktin Nr. 1 – nuk ka arritur qëllimin e saj të orientimit të ofertës tek një operator i caktuar. Ky anulim pa kërkuar fare sqarime shtesë nga ne, si operatori me ofertën më të ulët, thëllon bindjen tonë se AK nuk ka vepruar në përputhje me ligjin dhe parimet e një procesi të drejtë.

Në përputhje me Nenin 59 dhe Nenin 72 të LPP-së, AK kishte mundësinë dhe detyrimin të kërkonte sqarime shtesë për ofertën tonë, por në vend të kësaj, ka marrë një vendim arbitrar për anulim. Kjo tregon një shmangie nga detyrimet ligjore dhe një mungesë objektiviteti në këtë proces.

Kërkesat Tona

Për këto arsye, ne kërkojmë nga OSHP që:

- 1. Të anulojë vendimin për eliminimin tonë dhe anulimin e procedurës së prokurimit.**
- 2. Të detyrojë AK-në të rishikojë procesin e vlerësimit në përputhje me ligjin, duke përjashtuar kërkesat diskriminuese dhe të panevojshme si specifikimet e detajuara për Produktin Nr. 1.**
- 3. Të garantojë që procesi të jetë transparent dhe i paanshëm, duke respektuar parimet e konkurrencës së lirë dhe trajtimit të barabartë**

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Sigurimi i tenderit, kosto e stafit për përpilimin e ofertës, kërkesa për rishqyrtim si dhe Ankesa pranë OSHP.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*